



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
ASAMBLEJA

Prot. 549

Tiranë, më 5.7.2023

Vendim nr. <sup>36</sup> \_\_\_, datë 5.7.2023

**Për pranimin e tre anëtarëve të jashtëm të Akademisë së  
Shkencave të Shqipërisë**

Referuar nenit 6 pika 3 të Ligjit nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, sipas të cilit personat me origjinë shqiptare që janë anëtarë me të drejta të plota të një akademie pjesëtare të "All European Academies", fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave, e cila formalizohet nga një mbledhje ceremoniale e Asamblesë;

Mbështetur në nenin 11 pikat 4 e 5 të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe me propozim të seksioneve gjegjëse të Akademisë;

Në përputhje me nenet 2, 6 dhe 8 të Rregullores për ceremonialin dhe solemnitetet në Akademinë e Shkencave;

Asambleja, në mbledhjen e saj të datës 5 korrik 2023,

**Vendosi:**

1. Të pranojë anëtarë të jashtëm të saj z. Fejzullah Krasniqi, z. Mehmet Kraja dhe z. Sabri Hamiti, anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe personalitete të dijes dhe kulturës shqiptare.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Kryesia, kryetarët e seksioneve, sekretari shkencor dhe kancelari.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINÛSHI

KRYETAR

